

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6398  
E premte, 27 gusht 2021  
çmimi 0.40 €

Kosova dhe Maqedonia e Veriut rrezikojnë ta humbin statusin e vendeve të sigurta **FAQE 2**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TETËMBËDHJETË VIKTIMA DHE 2 295 QYTETARË KANË REZULTUAR POZITIVË NË 24 ORËT E FUNDIT NË KOSOVË ME VIRUSIN COVID **FAQE 4-5**

## QEVERIA HESHT PËRBALLË SHIFRAVE ALARMANTE TË COVIDIT



Numri i të vdekurve dhe i të infektuarve nga Covid-19 të enjten ka qenë i lartë. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë raportuar 18 raste të të vdekurve nga Covidi dhe 2 295 raste të të infektuarve me virus. Përballë këtyre shifrave qeveria ka heshtur. As kryeministri Albin Kurti dhe as ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, nuk janë deklaruar rreth pandemisë prej se shifrat e të vdekurve dhe të infektuarve nga virusi Covid janë rritur ditët e fundit

**Qeveria Haradinaj, Kurti 1 dhe Hoti nuk respektuan afatet ligjore për deklarimin e pasurisë** **FAQE 3**



**Protestohet me thirrjen 'Qeveria i ka duart me gjak'** **FAQE 7**

### AKTUALE



**KOALICIONI I OJQ-ve: EMËRONI MË SHUMË GRA KOMISIONARE DHE KRYESUESE TË VENDVOTIMEVE** **F.7**

**JAPONIA DHURON PAJISJE MJEKËSORE PËR SHSKUK-në** **F.5**

**65 PËR QIND E PUNONJËSVE ARSIMORË NË MITROVICË JANË VAKSINUAR KUNDËR COVIDIT** **F.6**

### EKONOMI



**KURTI NË TAKIM ME VELIAJN: RITJIA EKONOMIKE DO TË ARRIJË NË 7.9 PËR QIND** **F.8**

**FITIMET E KOMPANIVE BOTËRORE PO DËMTOHEN NGA VARIANTI 'DELTA'** **F.8**

### SPORT



**RONALDO RIKTHEHET NË MANCHESTER, POR TASH SI LOJTAR I CITYT** **F.10**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Kosova dhe Maqedonia e Veriut rrezikojnë të humbin statusin e vendeve të sigurta

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kosova dhe Maqedonia e Veriut rrezikojnë të hiqen së shpejti nga lista e të ashtuquajturave shtete të sigurta sa i përket pandemisë së koronavirusit. "Radio Evropa e Lirë" mëson nga burime të besueshme se Sllovenia, si vend kryesues i Bashkimit Evropian, ka përpiluar një listë të re të vendeve në të cilat duhet të kthehen masat kufizuese sa i takon lëvizjes në BE për shkak të përkeqësimit të situatës epidemiologjike.

Shtetet anëtare të BE-së do të votojnë në ditët në vijim për miratimin e listës së përditësuar. Përveç Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, mësohet se BE-ja ka përfshirë në listën e vendeve të



pasigurta edhe Malin e Zi, Izraelin, Shtetet e Bashkuara dhe Libanin.

Në parim, sipas burimeve të BE-

së, nga vendet që nuk janë në listën e "vendeve të sigurta" nuk lejohet hyrja në BE, pos në rastet kur udhëtimet janë të

domosdoshme.

Po ashtu, kufizimet nuk vlejnë për ata që në territorin e ndonjë vendi të Bashkimit Evropian kanë vendbanim ose udhëtojnë zyrtarisht.

Përpara fillimit të sezonit veror dhe pas përmirësimit të situatës epidemiologjike, BE-ja i ka hequr kufizimet e udhëtimit për qytetarët e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Deri në pushimet verore BE-ja i ka përditësuar listat çdo dy javë, në përputhje me situatën epidemiologjike në secilin vend veç e veç. Kjo praktikë do të vazhdojë tani që institucionet evropiane po i kthehen funksionimit normal, pas

pushimeve verore.

Shteteve u jepet statusi i sigurt nëse regjistrojnë maksimum 75 raste të reja me koronavirus në 100 000 banorë, në 14 ditët e fundit.

Në maj, BE-ja ka miratuar të ashtuquajturën "frenë emergjente", sipas së cilës, ndalimi i udhëtimit për qytetarë të vendeve të caktuara mund të riaktivizohet urgjentisht, nëse situata epidemiologjike përkeqësohet me shpejtësi.

BE-ja ka vendosur kufizime për udhëtimet e parëndësishme për qytetarët e të ashtuquajturave vende të treta qysh në mars të vitit 2020, kur edhe ka shpërthyer pandemia e koronavirusit.

## BE-ja paralajmëron vendet që rekomandojnë doza shtesë të vaksinës

BRUKSEL, 26 GUSHT - Vendet e Bashkimit Evropian mund të përballen me pasoja ligjore për shkak të rekomandimeve për një dozë shtesë të vaksinës kundër koronavirusit për faktin se një dozë përforcuese ende nuk është miratuar nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) ka njoftuar Komisioni Evropian.

Agjencia Evropiane e Barnave ka theksuar vazhdimisht se duhet të ketë më shumë të dhëna para se të miratojë përdorimin e një doze shtesë. Deri më tani tetë vende evropiane kanë rekomanduar vaksinimin me një dozë shtesë dhe disa të tjera pritet të marrin

të njëjtin vendim. "Dozat përforcuese aktualisht nuk janë pjesë e autorizimit të vaksinave për Covid-19 dhe ende nuk i janë nënshtruar një vlerësimi shkencor nga EMA në mungesë të të dhënave të mjaftueshme", ka theksuar Komisioni Evropian në një deklaratë për "Reuters" të enjten.

Komisioni Evropian ka njoftuar se vendet anëtare mund të vendosin veç e veç për një rekomandim të tillë, mirëpo tërësi vërejtjen se ato mbajnë pastaj barrën e çdo pasojë ligjore dhe kërkesash për kompensim, në rast se dikush ka efekte anësore të papritura. Komisioni, gjithashtu, tha se

edhe kompanitë do të kenë përgjegjësi nëse dozat shtesë administrohen pa miratimin e EMA-s. "Për shembull, nëse një efekt anësor pas një doze përforcuese shkaktohet nga problemet e prodhimit, prodhuesi i vaksinave do të mbetet përgjegjës për të", ka theksuar Komisioni Evropian.

Disa vende të BE -së, përfshirë ato më të mëdhatë, kanë skema kompensimi që kanë për qëllim t'i dëmshpërblejnë viktimat e mundshme jashtë gjykatave, por kriteret për rimbursimet ndryshojnë shumë.

Në disa vende pacientët që kanë ankesa do të duhet të shkojnë drejtpërdrejt në gjykata



për ta zgjidhur çështjen e tyre. Të dhënat zyrtare nga Danimarka, Gjermania, Norvegjia dhe Zvicra tregojnë se

që nga fillimi i fushatës së vaksinimit, qindra padi për kompensim janë paraqitur nga individët.

## Tri vende të NATO-s përfundojnë evakuimet nga Afganistani



KABUL, 26 GUSHT - Tri vende të NATO-s, Holanda, Belgjika dhe Hungaria, thanë se kanë përfunduar operacionet e tyre për evakuimin e personelit nga Afganistani dhe të shtetasve afganë që i kanë ndihmuar. Presioni për t'i përfunduar evakuimet e mijëra të huajve dhe afganëve është shtuar, pasi Shtetet e Bashkuara dhe aleatët paralajmëruan për një sulm të mundshëm terrorist në aeroportin e Kabulit.

Afganistani ka rënë nën kontrollin e militantëve talebanë më 15 gusht. Që atëherë, mbi 82 000 njerëz janë nxjerrë me avionë nga Kabuli. Mijëra të tjerë presin brenda dhe jashtë aeroportit, me

shpresën se do të mund të largohen.

Afati për evakuim është 31 gusht.

Qeveria holandeze tha se do t'i ndalojë sot fluturimet e evakuimit nga Kabuli. Ajo pranoi se ky është një "moment i dhimbshëm", pasi disa njerëz do të mbeten në Afganistanin e sunduar nga talebanët.

Personeli i Ambasadës Holandeze dhe ekipi ushtarak në Aeroportin e Kabulit do të fluturojnë me aeroplanët e fundit të enjten, ka njoftuar qeveria holandeze.

Në Belgjikën fqinje, kryeministri Alexander De Croo ka theksuar se vendi i tij i ka përfunduar operacionet e evakuimit, pasi

burimet amerikane e kanë informuar qeverinë e tij për një sulm të afërt me bombë rreth aeroportit të Kabulit.

De Croo ka thënë, në një konferencë për media, se Belgjika ka evakuuar rreth 1 400 njerëz nga Kabuli. Në Budapest, Ministria e Mbrojtjes e Hungarisë tha se dy avionët e saj ushtarakë dhe të gjithë trupat e saj që kanë marrë pjesë në evakuime janë larguar nga Afganistani dhe janë kthyer në Hungari. Ministri i Jashtëm i Hungarisë, Peter Szijjarto, një ditë më parë tha se fluturimet evakuuese të Hungarisë nga Afganistani janë drejt fundit dhe se Hungaria ka nxjerrë më shumë se 500 njerëz nga Kabuli.

# Qeveria Haradinaj, Kurti 1 dhe Hoti nuk respektuan afatet ligjore për deklarin e pasurisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Përfaqësues të Lëvizjes "Fol" kanë mbajtur të enjten konferencë për media, me ç'rast kanë publikuar raportin "(Mos)zbatim i Ligjit për Deklarim të Pasurisë nga qeveria Haradinaj, Kurti 1 dhe Hoti".

Mexhide Demolli-Nimani, drejtore ekzekutive e Lëvizjes "Fol", ka theksuar se ky raport, përveç një analize të bërë ligjit aktual që është në fuqi dhe projektligjit që është duke u hartuar nga qeveria aktuale, ka monitoruar publikimin e formularëve të deklarin të pasurisë nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe ofron të dhënat për secilin prej ministrave dhe zëvendësministrave të tri qeverive të kaluara; qeverisë Haradinaj, Kurti 1 dhe Hoti në lidhje me respektimin e afateve

ligjore për deklarin e pasurisë me rastin e emërimit, deklarin e rregullt vjetor dhe deklarin me rastin e shkarkimit apo përfundimit të mandatit. Albana Hasani, hulumtuese në Lëvizjen Fol, ka thënë se nga të gjeturat kryesore të raportit sa i përket respektimit të afateve ligjore nga ministrat dhe zëvendësministrat e tri qeverive, del se nga 131 ministra dhe zëvendësministra të qeverisë Haradinaj, vetëm 62 prej tyre kishin respektuar afatet ligjore për deklarin të pasurisë me rastin e emërimit në këto pozita (pra brenda një muaji nga emërimi në detyrë), si dhe deklarin e rregullt vjetor, mirëpo asnjë nga ta nuk e ka deklaruar pasurinë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare. "Nga 45 ministrat dhe zëvendësministrat e qeverisë Kurti 1, vetëm 20 nga ta e kanë

respektuar afatin ligjor për deklarin të pasurisë me rastin e emërimit në këto pozita. Ndërkaq vetëm 15 nga ta e kanë bërë deklarin e pasurisë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare apo me rastin e shkarkimit nga detyra, kurse nga 77 ministrat dhe zëvendësministrat e qeverisë Hoti, vetëm 32 prej tyre e kanë respektuar afatin ligjor për deklarin të pasurisë me rastin e emërimit në këto pozita, duke deklaruar pasurinë brenda periudhës së paraparë me ligj. Asnjë nga zyrtarët e kësaj qeverie nuk e ka deklaruar pasurinë me rastin e dorëzimit të detyrës zyrtare, apo me rastin e shkarkimit", ka deklaruar Hasani. Ajo ka bërë me dije se këto të dhëna janë bazuar në formularët e publikuar në uebfaqen zyrtare të AKK-së. Gjithashtu, është thënë se,

pavarësisht se këta zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë me rastin e emërimit, lirimit nga detyra apo shkarkimit, këta zyrtarë nuk figurojnë në listën e personave që nuk e kanë deklaruar pasurinë, të publikuar në uebfaqen e AKK-së. Bazuar në këto gjetje dhe në analizën e kornizës ligjore aktuale dhe projektligjit që është duke u punuar nga Qeveria e Kosovës, Lëvizja "Fol" ka dhënë disa rekomandime: Të rritet vigjilenca e zyrtarëve publikë në lidhje me respektimin e afateve ligjore për deklarin e pasurisë me rastin e emërimit, deklarin e rregullt vjetor dhe deklarin me rastin e përfundimit të mandatit apo shkarkimit; Të largohet kategoria e mjekëve, profesorëve dhe asistentëve universitarë nga lista e subjekteve deklaruuese të deklarin të pasurisë, që

parashihet të bëhet në Ligjin e ri për Deklarimin e Pasurisë ngaqë përfshirja e këtyre kategorive do të rrezikonte pamundësimin e zbatimit të ligjit në praktikë për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe burimeve njerëzore të AKK-së, si dhe do të ndikonte në dekurajimin e tyre në kryerjen e funksioneve. Ligji duhet të fokusohet në zyrtarët e lartë publikë dhe në disa kategori të tjera që janë potencialisht më të ekspozuar ndaj korrupsionit; Të largohet mundësia e pranimit të dhuratave të rastit nga zyrtarët publikë; Dhe të rritet bashkëpunimi i agjencisë kompetente me policinë, prokurorinë, administratën tatimore, Njësinë e Inteligjencës Financiare dhe institucionet e tjera relevante në lidhje me shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve në lidhje me deklarin e pasurisë.



## Mehaj në Shqipëri: Me Peleshin u zotuar t'i zhvillojmë forcat tona të armatosura

TRANË, 26 GUSHT (ER) - Me nderime të larta ushtarake, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, u prit të enjten nga homologu i tij nga Republika e

Shqipërisë, Niko Peleshi. Ministri Mehaj, duke falënderuar ministrin Peleshi për mikpritjen, ka theksuar se vizita zyrtare në Shqipëri është

vizitë në shtëpinë e vëllezërve e motrave tona. Pas takimit sy më sy, të dy ministrat u zotuan se rrugëtimi i të dy vendeve do të jetë i përbashkët në

perspektivën zhvillimore të forcave të armatosura, në shërbim të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe sigurisë dhe stabilitetit rajonal e më gjerë.





TETËMBËDHJETË VIKTIMA DHE 2 295 QYTETARË KANË REZULTUAR POZITIVË  
NË 24 ORËT E FUNDIT NË KOSOVË ME VIRUSIN COVID

## Qeveria hesht përballë shifrave alarmante të Covidit

Numri i të vdekurve dhe i të infektuarve nga Covid-19 të enjten ka qenë i lartë. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë raportuar 18 raste të të vdekurve nga Covidi dhe 2 295 raste të të infektuarve me virus. Përballë këtyre shifrave qeveria ka heshtur. As kryeministri Albin Kurti dhe as ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, nuk janë deklaruar rreth pandemisë prej se shifrat e të vdekurve dhe të infektuarve nga virusi Covid janë rritur ditët e fundit

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

Prishtinë, 26 gusht - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë shënuar 18 raste të të vdekurve nga Covid-19. Gjatë kësaj periudhe kohore janë shënuar edhe 2 295 raste të reja të të infektuarve me Covid. "Prej 12 406 testeve, 2 295 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 18 raste të të vdekurve. Sot janë shënuar 1 183 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 109 786. Në total numri i rasteve aktive është 24 939", është thënë në njoftimin e kësaj ministrie.

Shifra të frikshme vijnë edhe nga klinikat Covid dhe spitalet e përgjithshme rajonale. Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka njoftuar se në spitalet e Kosovës janë të shtrirë 995 pacientë të infektuar me koronavirus. Sipas njoftimit, 37 prej tyre janë në gjendje të rëndë shëndetësore, ndërsa 935 janë duke u trajtuar me oksigjeno-terapi. Këto shifra alarmante nuk i kanë bërë përshtypje Qeverisë së Kosovës për të ndërmarrë ndonjë masë. As kryeministri Albin Kurti dhe as ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, nuk janë deklaruar rreth pandemisë prej se shifra e të vdekurave nga virusi Covid është dyshifrore, kurse ajo e

infektiveve katërshifrore. Gjatë këtyre ditëve kryeministri ka marrë pjesë në disa aktivitete kulturore, por nuk është deklaruar për pandeminë dhe nuk ka vizituar ndonjë institucion shëndetësor. Mosreagimi i qeverisë ndaj rritjes së rasteve ka bërë që opozita të akuzojë qeverinë për dështim të menaxhimit të pandemisë Covid-19.

Sipas zyrtarëve opozitarë, qeveria po silltet sikurse nuk po ndodh asgjë. "Këtë gjendje shqetësuese s'mund ta normalizojmë. S'është normale. As ta politizojmë sepse në beteja si këto, as që dua të marr ndonjë votë. Por s'mund të sillemi sikurse nuk po ndodh asgjë.

S'mund t'i kapërcejmë gjithë këto vdekje tragjike vetëm si numra qa na shpërfaqen në orën tre e gjysmë. Qeveria vazhdon të silltet sikur asgjë nuk po ndodh, sikur asgjë s'ka në dorë", ka thënë kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Ai e ka ftuar kryeministrin që të merret me pandeminë dhe t'i lë aktivitetet e tjera. Ditë më parë kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që të japë dorëheqje. "Shifrat janë alarmante dhe janë më të mëdhatë që nga marsi i vitit 2020, pra jemi duke shprehur shqetësimin tonë për mënyrën se si po menaxhohet sfida ose rreziku më i madh", është shprehur ai.

Një ditë më parë publicistja Kimete Berisha ka kërkuar që të shpallet gjendje e jashtëzakonshme për shkak të përhapjes së madhe të Covidit. Për gjendjen e rënduar pandemike ajo e ka bërë përgjegjës ministrin e

Shëndetësisë, Arben Vitia. "Gjendje e jashtëzakonshme! Arben Vitia është përgjegjësi kryesor që sot Kosova është një ndër vendet më të rrezikshme në botë sa i përket përhapjes së Covid-19. Sot do të duhej të shpallej gjendje e jashtëzakonshme në Kosovë, ndërsa vendi duket i braktisur dhe absolutisht jashtë kontrollit! Askush nuk merret me pandemi! Vdesin dhjetëra qytetarë e ministri i Shëndetësisë nuk merret me temën e pandemisë! Kush ia financon heshtjen Arben Vitisë?", ka shkruar ajo në profilin e vet në "Facebook".

Ministria e Shëndetësisë ka treguar se në 24 orët e fundit janë dhënë 16 862 doza të vaksinës. Një ditë më parë janë dhënë 18 326 doza të vaksinës. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 16 862 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 747 898 doza të vaksinës. Deri më sot 256 235 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

# Japonia dhuron pajisje mjekësore për ShSKUK-në

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Ambasada e Japonisë në Kosovë, përmes Organizatës "Aksioni për Nëna dhe Fëmijë", i ka dhuruar një donacion me pajisje mjekësore Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës që kushton 53 570 euro. Donacioni, të cilin zyrtarisht e

pranoi drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, përmban tre mikroskopë trinokularë dhe dy inkubatorë transportues. Krasniqi ka falënderuar shtetin japonez për ndihmën e vazhdueshme, në veçanti gjatë periudhës së pandemisë, e cila ka ndikuar për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe për ngritjen e nivelit të sigurisë të personeli shëndetësor. "Kjo kohë

ka treguar se Kosova ka shumë miq në botë, në mesin e tyre Japoninë, dhe bashkërisht jemi shumë të sigurt që do t'ia dalim ta menaxhojmë pandeminë edhe në nivel global. Edhe koronavirusi ka treguar se sa të afërt janë njerëzit mes vete, pavarësisht ku jetojnë dhe, në të njëjtën kohë, sa të ndjeshëm jemi ndaj kërcënimeve të përbashkëta që i kanosen njerëzimit në përgjithësi", ka thënë

Krasniqi.

Njëri mikroskop trinokular do të instalohet në Institutin e Patologjisë në Qendrën Klinike Universitare, ndërsa dy të tjerë në Spitalin e Prizrenit dhe në Spitalin e Gjilanit. Spitali i Gjakovës dhe i Mitrovicës, ndërkaq, do të pajisen me nga një inkubator transportues.

Ambasadori i Japonisë në Kosovë, Ogasawara Mitsunori, shpreson

që pajisjet e dhuruara do t'u ndihmojnë spitaleve që të ofrojnë trajtim më të mirë mjekësor për pacientët. "Së bashku me trajtimin e pacientëve të infektuar me Covid-19 është e rëndësishme që njerëzit në Kosovë ta përmirësojnë sistemin shëndetësor, për të ofruar shërbime shëndetësore, duke përfshirë kujdesin shëndetësor të nënës dhe fëmijës", ka thënë Mitsunori.



## Osmanit i kërkohet ta shkarkojë Sami Kurteshin nga KQZ-ja

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Demokraci Plus (D+) ka kërkuar nga presidentja Vjosa Osmani-Sadriu shkarkimin e anëtarit të KQZ-së, Sami Kurteshi. "Ne konsiderojmë që anëtari i KQZ-së, Sami Kurteshi, me veprimet e tij është duke dëmtuar seriozisht statusin dhe integritetin e KQZ-së. Në mbledhjen e sotme të KQZ-së z. Kurteshi ka pranuar se është përfshirë në një incident me një nëpunës të

KQZ-së, duke marrë përsipër rolin e policisë në vend se ta denoncojë në organet përgjegjëse personin në rast të mosrespektimit të masave për mbrojtje nga Covid-19. Një ditë më herët z. Kurteshi kishte deklaruar se nuk e ka sulmuar askënd. Ndryshimi i deklaratave nga një i emëruar publik është moralisht e gabuar. Ky nuk është rasti i vetëm kur z. Kurteshi dëmton integritetin e KQZ-së. I njëjti në

vazhdimësi në mbledhjet e KQZ-së ka përdorur gjuhë fyese dhe përçarëse, mizogjene dhe bullizëm. Andaj, kërkohet nga presidentja Osmani-Sadriu, që duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 61, paragrafin 5, shkronja d, ta shkarkojë anëtarin e KQZ-së Sami Kurteshi, për ta mbrojtur statusin dhe integritetin e KQZ-së", është thënë në kërkesën e Demokraci Plus.



## Brenda tre muajsh do të ndërtohet qendra për personat me nevoja të veçanta në Skenderaj

SKENDERAJ, 26 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije të enjten, se brenda tre muajsh do të ndërtohet qendra për personat me nevoja të veçanta në këtë komunë. "Jam jashtëzakonisht i lumtur që, ashtu siç kam premtuar, po fillojmë ta jetësojmë projektin për

ndërtimin e qendrës për personat me nevoja të veçanta të komunës sonë falë marrëveshjes së bashkëfinancimit që sot nënshkrova me drejtorin e Shoqatës 'Qëndresa Kosovare', Islam Cakaj. Kështu brenda tre muajve personat me nevoja të veçanta të komunës sonë do të kenë qendrën e tyre

rehabilituese me një objekt modern, me salla të rehabilitimit fizik, trajtimit psiko-social, trajnimit dhe përgatitjes së tyre profesionale për tregun e punës", ka thënë kryetari Jashari.

Ai ka falënderuar shoqatën "Qëndresa Kosovare" për këtë donacion dhe donacionet e tjera të ofruara për këtë



## Policia ndalon një person në Prishtinë, në veturë i gjenden dhjetë pako me drogë



Prishtinë, 26 gusht (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë realizimit të detyrave patrulluese Njësitë Policore për Reagim të Shpejtë (NJRS) ka ndaluar një person i dyshuar i cili kishte qenë me veturën e tipit BMW X5, me targa vendore, duke e drejtuar atë në rrugën "Xheladin Hana" në Prishtinë. Gjatë kontrollit të automjetit zyrtarët policorë kanë hasur në disa paketime të dyshuara me substancë narkotike të llojit marijuanë. Personi i dyshuar (B. C.) është arrestuar, mbi dyshimin e bazuar për përfshirje në veprën penale "Blerja, posedimi, shitja ose

shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge" nga neni-273.

Për këtë rast është angazhuar edhe Njësia Policore e Antidrogës, e cila, së bashku me njësinë e Krimteknikës Regionale në Prishtinë, kanë ndërmarrë veprime të mëtejme dhe gjatë kontrollit të personit dhe të veturës janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë paketime me substancë të dyshuar narkotike marijuanë, që dyshohet të jenë afërsisht rreth dhjetë kilogramë. "Janë ndërmarrë veprime të tjera operative policore dhe gjatë kontrollit të banesës së të

dyshuarit, e cila gjendej në Prishtinë, janë gjetur dokumentacione të ndryshme personale (letërnjoftime, pasaporta) të cilat dyshohet se janë përdorur për falsifikimin e vizave të një shteti të huaj. Vlen të potencohet se gjatë kontrollit policor janë konfiskuar rreth 300 euro, 2 300 dinarë të Serbisë, 10 denarë të Maqedonisë së Veriut si dhe telefon mobil 'Samsung' dhe 'Nokia'. Lidhur me rastin është kontaktuar edhe prokuroria kompetente dhe me aktvendim të saj i dyshuari është dërguar në qendrën e mbajtjes për procedurë të mëtejme", ka njoftuar Policia e Kosovës.

## 65 për qind e punonjësve arsimorë në Mitrovicë janë vaksinuar kundër Covidit

MITROVICË, 26 GUSHT (ER) - Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Skënder Avdiu, ka ftuar në takim drejtorët e të gjitha institucioneve edukativo-arsimore për të diskutuar rreth përgatitjeve të bëra me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2021/22. Gjatë këtij takimi drejtorët e shkollave raportuan për përgatitjet që i kanë bërë në shkollat e tyre si pastrimet e përgjithshme të objekteve shkollore, dezinfektimet, furnizimin me materiale higjienike dhe dezinfektuese, vaksinimet e mësimitdhënësve, përpilimet e orareve shkollore sipas skenarëve të udhëzuesit dhe aktivitetet e tjera të ndërmarrë.

Ndërsa i drejtori i DKA-së, Skender Avdiu, ka folur rreth përgatitjeve që i ka bërë MASHTI rreth fillimit të vitit shkollor, si



udhëzimin administrativ për kalendarin e vitit shkollor, udhëzuesin për organizimin e procesit edukativo-arsimor sipas skenarëve, protokollin për masat anti-Covid, si dhe furnizimin me

tekste shkollore. Drejtori i ShFMU "Nonda Bulka" shprehu pakënaqësinë e tij rreth rrënimin të objektit të kësaj shkolle në pjesën veriore të qytetit dhe fillimin e ndërtimit të

universitetit paralel.

Kësaj pakënaqësie dhe këtyre shqetësimeve iu bashkuan të gjithë drejtorët e shkollave dhe DKA-ja dhe kërkuan nga organet kompetente të reagojnë.

Në këtë takim u tha se të gjitha shkollat janë të gatshme ta fillojnë mësimin më 1 shtator, ku u theksua se përqindja e punonjësve arsimorë të vaksinuar është në rritje e sipër, aktualisht 65 për qind e punonjësve arsimorë janë vaksinuar, kurse pjesa tjetër e mësimitdhënësve i kanë terminet e caktuara dhe pritet të vaksinohen në ditët në vijim.

Në takim ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e organizatës gjermane GIZ të cilët i njoftuan shkollat për procesin e aplikimit dhe përzgjedhjes së dy shkollave të mesme të ulëta, për projektin "Aftësimi për Tregun e Punës" (Fit for Jobs) për mbështetjen e tranzicionit të nxënësve nga shkollat e mesme të ulëta në shkolla profesionale, e pastaj tranzicionin e tyre në tregun e punës.

## Shpërndahen makina për kositjen e barit për 16 shkolla të Podujevës

Podujevë, 26 gusht (ER) - Në kuadër të investimeve me të cilat synohet të përmirësohet mirëmbajtja e hapësirave të jashtme të shkollave, të enjten janë shpërndarë 16 makina për

kositje të barit për shkollat e komunës së Podujevës. Në këtë ceremoni i pranishëm ishte kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, dhe drejtori i Arsimit, Avni Fetahu. Kryetari Bulliqi ka

thënë se kjo mbështetje nga komuna do t'i ndihmojë shkollat për mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme shkollore. Po ashtu, dy makina janë dhuruar falas nga operatori ekonomik,

ndërsa komuna është në fazën tenderuese për blerjen edhe të 10 makinave të tjera.

Gjithsejtë makina që do të shpërndahen gjatë këtij viti janë 28.



# Protestohet me thirrjen 'Qeveria i ka duart me gjak'

Dhjetëra qytetarë kanë protestuar të enjten në Prishtinë për të kërkuar drejtësi për vrasjen e 18 vjeçes nga Ferizaj, Marigona Osmani. Vrasja e grave në Kosovë është kërkuar "të trajtohet si urgjencë kombëtare". Gjatë protestës, disa nga pjesëmarrësit i kanë hedhur ngjyrë të kuqe objektit të Qeverisë së Kosovës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 GUSHT - Vrasja e grave në Kosovë është kërkuar "të trajtohet si urgjencë kombëtare", gjatë një proteste të mbajtur të enjten në Prishtinë. Protesta e Kolektivitetit për Mendim dhe Veprim Feminist është

zhvilluar pas vrasjes së një 18-vjeçeje në Ferizaj, ditë më parë. Partneri i saj, D. K., dhe i dyshuari tjetër A. S., janë arrestuar nga policia si të dyshuar për këtë vrasje. Protestuesit kanë marshuar nga Ministria e Drejtësisë, për të vazhduar te Ministria e Punëve të Brendshme dhe krejt në fund para



qeverisë ku kanë hedhur ngjyrë të kuqe. "Qeveria i ka duart me gjak", "Nuk durojmë ma", "Mos u jepni zemër vrasësve", "Gra, revoltohuni!", "Duam vepra, jo fjalë", "Siguri për gratë", "Vrasja e grave të trajtohet si urgjencë kombëtare", disa nga thirrjet e protestuesve. Kaltrina Fejzullahu, aktiviste, ka kërkuar shkarkimin e të gjithë

gjykatësve, prokurorëve dhe policëve që nuk i trajtojnë rastet me seriozitet, sipas Kodit të Procedurës Penale. "Kërkojmë shkarkimin e gjyqtarëve, policëve dhe prokurorëve për mostrajtimin me seriozitet dhe ndjeshmëri gjinore. Kërkojmë llogaridhënie nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Inspektorati Policore për këto

shkelje. Kërkojmë plan konkret nga Qeveria e Kosovës për luftimin e dhunës në baza gjinore", ka thënë Fejzullahu. Kurse Beshkë Guri ka pohuar se vrasja e 18-vjeçes duhet të jetë alarmi i fundit për institucionet. "Është alarmi i fundit për shtetin që ta kthejë vëmendjen te jeta e grave. Vrasja e Marigonës është një tjetër rast", ka thënë Guri.

## Koalicioni i OJQ-ve: Emëroni më shumë gra komisionare dhe kryesuese të vendvotimeve

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Koalicioni i OJQ-ve Demokracia në Veprim u është drejtuar me një letër të hapur subjekteve politike, të cilave u ka bërë thirrje që të emërojnë më shumë gra komisionare dhe kryesuese të vendvotimeve në zgjedhjet lokale të 17 tetorit. "Përgjatë proceseve të kaluara zgjedhore përfshirja e grave në zgjedhje, me theks në trupa menaxhuese të zgjedhjeve, ka qenë minimale. Ne i çmojmë veprimet që ju keni ndërmarë në të kaluarën për ta adresuar këtë problematikë dhe ju rikujtojmë që në vitin 2015 ju keni nënshkruar një deklaratë për rritjen e pjesëmarrjes së grave në këto trupa, duke u



zotuar, mes të tjerash, që të propozoni gra në të gjitha pozitat e trupave menaxhuese të zgjedhjeve në nivel prej të paktën 40 për qind. Sidoqoftë, ky

zotim nuk është përmbushur në asnjë nga proceset zgjedhore të organizuara që nga viti 2015", është thënë në këtë njoftim të koalicionit të OJQ-ve

Demokracia në Veprim. Sipas këtij koalicioni të OJQ-ve, në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2017 gratë përbënin vetëm 10 për qind të përbërjes së KKZ-ve, 29 për qind të komisionarëve në ditën e zgjedhjeve, si dhe vetëm 14 për qind të kryesuesve të vendvotimeve. "Përderisa afati zyrtar për krijimin e vendvotimeve fillon më 15 shtator, ne jemi të sigurt që ju tashmë keni filluar procesin e rekrutimit të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve. Kjo periudhë është një mundësi e shkëlqyer për ju, që në procesin e përpilimit të listave të komisionarëve, në përputhje me parimin e barazisë gjinore dhe

në respektim të deklaratës së nënshkruar nga vetë ju, të propozoni numër të barabartë të komisionarëve nga të dyja gjinitë, apo minimalisht në nivelin prej 40-përqindësh. Gratë duhet të zënë vend meritore të barabartë edhe në kuadër të propozimeve për kryesues të vendvotimeve, prandaj duhet të bëni përpjekje serioze që të arrini këto objektiva dhe të jepni shembull që subjektet tuaja në fundament janë demokratike, gjithëpërfshirëse dhe ofrojnë mundësi të barabartë për të gjithë", është theksuar në njoftimin e koalicionit të OJQ-ve Demokracia në Veprim.

## Këshilli i Evropës përkrah Asociacionin e Komunave të Kosovës

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Frank Power, ka pritur të enjten në një takim drejtorin ekzekutiv të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim. Ky takim është organizuar si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë që ka Asociacioni i Komunave të Kosovës me Këshillin e Evropës. Në këtë takim u bisedua për projektin "Promovimi i Demokracisë Lokale", i cili është

duke u zbatuar nga ekipi i Këshillit të Evropës, Zyra në Prishtinë, në bashkëpunim të ngushtë me Asociacionin e Komunave të Kosovës, si partner kryesor. Gjatë takimit bashkëbiseduesit shprehën gatishmërinë për ta rritur bashkëpunimin mes Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Këshillit të Evropës. Power ka theksuar se është jashtëzakonisht i kënaqur me bashkëpunimin me AKK-në dhe shpreson që një bashkëpunim i

tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Në anën tjetër, Ibrahim ka shprehur kënaqësinë e tij për bashkëpunim dhe ka theksuar që për AKK-në është jetik bashkëpunimi me Këshillin e Evropës, për zhvillimin dhe forcimin e demokracisë lokale në Kosovë. Duhet theksuar që AKK-ja është në cilësinë e vëzhgueses në Kongresin e Pushtetit Lokal të Këshillit të Evropës me seli në Strasburg, Francë.



## Fitimet e kompanive botërore po dëmtohen nga varianti 'Delta'

PRISHTINË, 26 GUSHT - Fitimet e korporatave botërore janë duke shënuar rënie në tremujorin e tretë të këtij viti, për herë të parë në 18 muajt e fundit, pas fitimeve rekord në periudhën prill - qershor. Sipas përlogaritjeve të "Reuters"-it, përhapja e variantit "Delta" të Covid-19 ka çrregulluar zinxhirin botëror të furnizimit dhe ka rritur kostot e punës. Stimujt masivë fiskalë për ta mbështetur rimëkëmbjen e ekonomisë botërore gjeneruan një kërkesë të lartë konsumatore në tremujorin e dytë të vitit, ndërsa kompanitë që përballeshin me mungesë të furnizimit dhe rënien e rezervave rritën çmimet për ta kompensuar rritjen e kostove të inpueteve.

Kjo ndihmoi në rritjen e fitimeve neto të kombinuara të 2 542 kompanive botërore, me një kapitalizim tregu prej 734 miliardë dollarësh gjatë tremujorit të dytë të këtij viti. Por, fitimet parashikohet të shënojnë rënie me rreth 8 për qind në

periudhën korrik - shtator, në një mesatare prej 678.2 miliardë dollarësh.

Fitimet e kompanive amerikane parashikohet të bien në 7.2 për qind në tremujorin e tretë të këtij viti, pasi u rritën me 12.4 për qind në tremujorin e dytë. Një dollar më i fortë po dëmton eksportuesit amerikanë dhe një rënie e mëtejshme e normave të interesit mund të "ngrijë" fitimet e bankave.

Gjithashtu, fitimet e firmave evropiane dhe aziatike parashikohet të shënojnë rënie prej 10.3-përqindësh dhe 9.6 për qind respektivisht. Sipas sektorëve, pronat e paluajtshme, ai financiar dhe sektori konsumator, pritet të bien 22.2 për qind, 18.8 për qind dhe 16.2 për qind respektivisht.

Analistët shprehen se në disa raste kompanitë do të jenë në gjendje të kalojnë kosto më të larta të konsumatorët e tyre, por nëse nuk do të jenë në gjendje ta bëjnë këtë, atëherë marzhet e fitimit do të shënojnë rënie.



## Kurti në takim me Veliajn: Rritja ekonomike do të arrijë në 7.9 për qind



PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, kanë pritur në takim miqësor kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe nënkryetaren e Bashkisë, Anuela Ristani. Qeveria në njoftimin për media ka njoftuar se në këtë takim është diskutuar për pandeminë dhe ecurinë e procesit të vaksinimit në të dy shtetet. "Kryebashkiaku Veliaj u interesua për efektin e pandemisë në ekonomi, duke vlerësuar rolin dhe vullnetin e diasporës së Kosovës për t'i kontribuar zhvillimit ekonomik. Kryeministri Kurti tha se ekonomia ka filluar të shënojë ngritje dhe, sipas projeksioneve, rritja

ekonomike do të arrijë në 7.9 për qind të bruto produktit vendor. Ai tha se është shënuar progres edhe në eksporte dhe mbledhje të tatimeve", është theksuar në njoftimin e qeverisë.

Po në këtë njoftim bëhet me dije se është biseduar edhe për ngjarjet kulturore që do të mbahen në kryeqytetet e të dy shteteve vitin e ardhshëm. "Prishtina do të jetë nikoqire e biennales 'Manifesta', ndërsa kryeqyteti shqiptar i aktiviteteve 'Tirana, Kryeqyteti European i Rinisë 2022'. Kryebashkiaku Veliaj tha se këto dy ngjarje janë mundësi e mirë për promovimin e artit dhe kulturës shqiptare", është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

## Nisin procedurat për hapjen e terminalit doganor në hapësirat e Trepçës

Prishtinë, 26 gusht (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka bërë me dije të enjten se ka autorizuar drejtorin e Doganave të

Kosovës për t'i nisur procedurat për hapjen e terminalit doganor shtetëror në hapësirat e Trepçës në Mitrovicë dhe ka treguar se do të vazhdojnë edhe me të

tjerat shumë shpejt. "Për një shtet të drejtë, dhe që çliron potencialin e biznesit", ka shkruar ministri Murati në llogarinë e vet në "Facebook".







# REPORTAZH NGA REHOVA, FSHATI I GURTË

**Nga: Gladiola HOXHA**

Vetëm dy kilometra larg Kolonjës, rrzë malit të Gramozit, ndodhet fshati turistik i Rehovës. Destinacioni ynë është zgjedhja ideale për t'iu larguar vapës përvëluese të verës.

Rehova njihet si fshati i gurtë, fshati i shtëpive shpinë më shpinë; fshat që ruan vlerat urbanistike arkitektonike e që dëshmon qytetërimin e veçantë në Kolonjë ku spikat tradita, kultura, artizanati, trashëgimia e pasur, historia e mikpritja. Është ky një fshat ku turistët hanë së bashku me banorët, si të ishin një familje. Ndalojmë fillimisht te bujtina e cila hapi për herë të parë dyert për turistët. Tashmë në të




gjithë fshatin numërohen rreth 15 shtëpi, ku gjithsecila mirëpret turistë vendës e të huaj.

Turizmi këtu lindi në një formë të veçantë. Ka qenë pikërisht

interesi dhe dëshira e të huajve për të qëndruar në këtë vend që nxiti vendësit të rikthehen në vendlindje e të investojnë në bujtina.

“Erdhën francezë në fillim dhe kërkuan. Na pyetën: ‘Prisni turistë apo jo?’. U thamë: ‘Me gjithë qejf’. Dhe kanë ardhur, i pritëm. Kanë ndenjur një natë, u ka pëlqyer. Pastaj kanë ndenjur dy net. Kur kanë qenë me familje kanë dashur që të punojnë me mua, bashkë për të gatuar; të shikojnë çfarë u bëjmë, si gatujmë ne. Kjo ka qenë nisma e parë. Kanë ardhur turistë nga shumë vende. Nuk e kemi ndryshuar strukturën e shtëpisë që është bërë që më 1925”, thotë e zonja e bujtinës.

Bujtinat kanë ruajtur identitetin arkitektonik me



elemente të gurit dhe të drurit, punuar me mjeshtëri. Por, çfarë ka Rehova për t'u vizituar? Çfarë mund të gjenin këtu turistët?

Karakteristikë e rehovallinjve është mikpritja. Të gjithë i hapin dyert e shtëpisë, edhe të huaj po të jenë; të dalin te

porta dhe të ftojnë. Tjetër gjë është trashëgimia kulturore me qendrën historike të fshatit e rrugët karakteristike. Çdo shtëpi është me sokak. Pastaj, turistët në Rehovë gjejnë ajrin e pastër, klimën, natyrën rrzë Gramozit. Gatimet tradicionale janë një tjetër arsye./Report TV.



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
 TEL: 045/82 82 82

# Përballje të zjarrta në Ligën e Kampionëve



**STAMBOLL, 26 GUSHT** - Është hedhur shorti në Ligën e Kampionëve për sezonin 2021/22. Goglat u rrotulluan në Turqi patën të gjithë vëmendjen e sportdashësve më të mëdhenj të futbollit, duke qenë se sezonin e ardhshëm pritet të ketë shumë herë më shumë surpriza në Ligën e Kampionëve dhe duke parë edhe ndryshimet e mëdha që ka sjellë merkatoja e kësaj vere. Shorti ishte i pamëshirshëm kësaj here, pasi në çdo grup thuajse ka përballje të mëdha. Në Grupin A vihet re përballja Manchester City-PSG, në Grupin B është dueli Atletico Madrid-Liverpool, derisa në Grupin C Borussia Dortmund-Ajax. Për të vijuar në Grupin D, ku Inter do të ketë përballë Real

**GRUPET E LIGËS SË KAMPIONËVE**

Grupi A: Manchester City, PSG, Leipzig, Clube Bruges  
 Grupi B: Atletico Madrid, Liverpool, Porto, Milan  
 Grupi C: Sporting, Dortmund, Ajax, Beshiktash  
 Grupi D: Inter, Real Madrid, Shakhtar, Sherif Tiraspor  
 Grupi E: Bayern, Barcelona, Benfica, Dinamo Kiev  
 Grupi F: Manchester United, Villarreal, Atalanta, Young Boys  
 Grupi G: Lille, Sevilla, Salzburg, Wolfsburg  
 Grupi H: Chelsea, Juventus, Zenit, Malmo

Madridin, Bayern e Barcelona përplasen në Grupin E, ndërsa Chelsea dhe Juventus në Grupin H. Ndeshjet e para 14/15 shtator, ndeshjet e dyta 28/29 shtator, ndeshjet e treta 19/20 tetor, ndeshjet e katërta 2/3 nëntor, ndeshjet e pesta 23/24 nëntor, ndeshjet e gjashta 7/8 dhjetor.

# Jorginho, futbollisti i vitit nga UEFA

**STAMBOLL, 26 GUSHT** - Mesfushori i Chelseat dhe Kombëtares së Italisë, Jorginho e ka fituar çmimin e lojtarit më të mirë të vitit nga UEFA. Ai pati një vit të jashtëzakonshëm me Chelsean duke e fituar Ligën e Kampionëve dhe Kampionatin Evropian me Italinë. Për çmimin e më të mirit, Jorginho i mundi N'Golo Kanten dhe Kevin De Bruyne. Ndërsa Thomas Tuchel është shpallur trajneri i vitit. Gjermani arriti ta mposhtë Josep Guardiolan dhe Roberto Mançinin. Portieri i Chelseat, Eduardo Mendy është shpallur portieri i vitit nga UEFA. duke lënë pas Thibaut Courtoisin e Real Madridit dhe Edersonin e Manchester Cityt. Ndërkohe nga Manchester City, Ruben Dias është vlerësuar mbrojtësi më i mirë. Ai fitoi garën me dyshen e Chelseat, Cesar Azpilicuetan dhe Rudigerin. Mirëpo nga Chelsea, N'Golo



Kante është vlerësuar si mesfushori më i mirë. Pas tij u renditen Jorginhon dhe Kevin de Bruyne. Ndërkohe futbollisti i

Borussia Dortmund, Erling Haaland është vlerësuar si sulmuesi më i mirë për sezonin 2020/21.

## SHKURT

### Prishtina dhe Peja mësojnë kundërshtarët në Ligën Ballkanike

Dy skuadrat e Kosovës në basketboll, Sigal Prishtina dhe Peja, të cilat sivjet do të garojnë në Ballkan Ligë (BIBL), i kanë kuptuar kundërshtarët nga shorti i tërhequr gjatë ditës së enjte. Dy herë kampionia e kësaj gare, Sigal Prishtina, do të bëjë pjesë në grupin B bashkë me skuadrat Ironi Rain Nahariya nga Izraeli, BC Akademik Plovdiv nga Bullgaria dhe KK TFT Skopje nga Maqedonia e Veriut. Kurse Peja do të jetë pjesë e grupit A, bashkë me ekipin Hapoel Galil Elion nga Izraeli, BC Balkan nga Bullgaria dhe dy skuadrat nga Maqedonia Veriore, KK Kumanovo dhe KK Navico Akademija FMP. Ekipet e Kosovës në ligën ballkanike garojnë që nga viti 2014. Stinori i ri i kësaj gare fillon më 12 tetor.

### Gittens përforcon Bashkimin

KB Bashkimi ka zyrtarizuar përforcimin e radhës. Skuadra nga Prizreni ka vazhduar përforcimin e ekipit në prag të fillimit të edicionit të ri. Së fundmi 'prizrenasit' kanë shtuar në radhët e tyre amerikanin Richaud Gittens. Gittens i gjatë 193 cm, luan në pozitë 2 dhe 3. Sezonin e kaluar ai ishte pjesë e skuadrës Barreirense në Superligë. Është ky përforcim i dytë i huaj nga "Arpagjikt" këtë merkato, ndërsa më parë kanë shtuar në radhët e tyre edhe vendorët Valon Bunjakun dhe Artin Gashi. Sezoni i ri në Superligën e Kosovës nis në mesin e muajit shtator.

### Dervishaj pritët nga drejtuesit e FVK-së

Trajneri Bujar Dervishaj, që jeton dhe vepron në Zvicër dhe është anëtar i Komisionit Profesional të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), është pritur në një takim pune nga kryetari Bahri Gjinovci dhe sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi. "Në takim u diskutuan çështje me rëndësi për volejbollin, ndërsa me theks të veçantë programi për akademinë e trajnerëve", thuhet në njoftimin e FVK-së.

### KB Prishtina paraqet Jani Palokajn

KB Sigal Prishtina ka njoftuar për nënshkrimin me basketbollistin e talentuar Jani Palokaj. Klubi kryeqytetas ka vazhduar përforcimet para nisjes së sezonit 2021/22 në Superligën e Kosovës në basketboll. Talenti shqiptar nga Kroacia, Jani Palokaj, vjen për ta ndihmuar Prishtinën drejt arritjes së objektivave. "Presidenti Burim Maraj dhe drejtori i klubit Edmond Azemi takuan super talentin shqiptar nga Kroacia, Jani Palokaj. Jani ka nënshkruar kontratën me klubin më të trofeshëm shqiptar. Jani u zotua se do të japë më shumë se maksimumin që t'i arrijë synimet e klubit nga kryeqyteti", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

## Do të aplikohet për anëtarësim në Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar

PRISHTINË, 26 GUSHT - Drejtuesit e KOK-ut, presidenti Ismet Krasniqi dhe nënpresidenti Milaim Kelmendi, kanë pritur drejtuesit e Komitetit Paralimpik të Kosovës (KPRK), në krye me presidenten Njomza Emini. Të dyja palët kanë biseduar për mundësinë e anëtarësimit sa më parë të Komitetit

Paralimpik të Kosovës në Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar (KPRN). Në emër të bordit ekzekutiv të KOK-ut, presidenti Krasniqi ka shprehur vullnetin dhe gatishmërinë që KOK-u ta ndihmojë KPRK-në në këtë proces, në mënyrë që paralimpistëve tanë t'u hapën dyert e

pjesëmarrjes në garat ndërkombëtare, në veçanti Lojërat Para. Po ashtu, u bisedua që sa më parë të formohen edhe federatat para, për t'i plotësuar kushtet për anëtarësim në Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar. Presidentja Emini falënderoi presidentin Krasniqi dhe nënpresidentin Kelmendi,



## Ronaldo rikthehet në Manchester, por tash si lojtar i Cityt

MANCHESTER, 26 GUSHT - Cristiano Ronaldo po i afrohet çdo çast e më shumë transferimit të Manchester Cityt. Nga Spanja, "AS" bën me dije se portugezi ka arritur marrëveshje me Manchester Cityn për pagën dhe gjatësinë e kontratës. Nga ana tjetër, kjo medie bën me dije se Juventusit dhe Manchester City po negociojnë për lojtarin që do të zbarkojë në Torino në kthim. City i ka ofruar një kontratë 2-vjeçare me 230 mijë paund në javë, teksa fiton 500 mijë paund në javë të "Zonja e Vjetër", Juve do të sulmues qendre dhe ka zgjedhur Gabriel Jesus para Sterlingut. Ndërkohë, një tjetër burim pretendon se ka marrëveshje mes të gjitha palëve dhe Ronaldo do të kalojë te Manchester City. Këtë lajm e bën të ditur Gonçalo Lopes, gazetar portugez, por mbetet të



shihet nëse lajmi do të konfirmohet nga mediat e mëdha. 36-vjeçari ka luajtur edhe për klubin tjetër nga Manchesteri,

Manchester United, nga viti 2003 deri në vitin 2009, ku është paraqitur në 196 ndeshje dhe ka shënuar 84 gola.

## Guardiola: Në vitin 2023 do të largohem nga City

MANCHESTER, 26 GUSHT - Trajneri Pep Guardiola nuk zhgënjën kurrë, në fushë dhe jashtë saj, në ato që thotë dhe bën. Tekniku katalunjas ka befasuar jo pak me deklaratën e tij të fundit duke lajmëruar largimin nga Manchester City pas përfundimit të kontratës më 2023. "Hapi i radhës do të jetë drejtimi i një ekipi përfaqësues. Më parë, pas shtatë vjetësh në krye të Cityt, kur të më përfundoj kontrata, më duhet të pushoj pak, të qetësohem e të studioj. Më pas do të më pëlqente të drejtoja një ekip në evropian, në Kupën e Amerikës apo në Botëror", ka thënë Guardiola në një intervistë për mediat braziliane duke iu përgjigjur më pas interesimit nëse do t'i pëlqente të drejtoje pesë herë kampionët e Botës. "Është një skuadër fantastike. Kam punuar me një pjesë të lojtarëve brazilianë dhe kam sfiduar shumë prej tyre. Brazili është gjithnjë një kandidat favorit, kështu ka qenë gjithnjë dhe kështu do të jetë", ka shtuar Guardiola.



### SHKURT

#### Juninho: Shpresoj të fitojmë tituj me Shaqirin

Legjenda Juninho ka vetëm fjalë të mira për Shaqirin, me të cilin shpreson që Lyoni të fitojë trofe. Xherdan Shaqiri është paraqitur te Lyoni, me të cilën skuadër ka nënshkruar deri më 2024. Në prezantimin e shqiptarit ishte edhe legjenda Juninho, drejtor sportiv i Lyonit që nga viti 2019. Ai ka vetëm fjalë të mira për Shaqën që ka fituar shumë trofe gjatë karrierës, përfshirë dy herë Ligën e Kampionëve dhe shpreson që përvoja e tij ta ndihmojë Lyonin. "Ai është lojtar i shkëlqyer. Kam folur me të dhe ai tregoi se dëshiron shumë të vijë këtu. Është profesionist i vërtetë. Shpresoj se do të fitojmë tituj me të. Kishim nevojë për një lojtar si Shaqiri. Ai do të na ndihmojë shumë. Është luftëtar dhe këtë e pamë gjatë Euro 2020", ka thënë Juninho.

#### Interi transferon Correan

Skuadra e Interit ka arritur marrëveshje me sulmuesin argjentinas Joaquin Correa nga Lazio. Lajmin e ka konfirmuar vetë klubi përmes një shkrimi të publikuar në faqen zyrtare "Twitter". Lojtari ka nënshkruar një kontratë me klubin deri më 30 qershor 2025. "FC Internazionale Milano njofton se Joaquin Correa është lojtar i ri i nerazzurrëve. Sulmuesi argjentinas i lindur më 1994 arrin nga Lazio në një bazë të përkohshme me detyrimin për ta transformuar huazimin në një transferim të përhershëm. Correa ka nënshkruar një kontratë me klubin deri më 30 qershor 2025. Mirë se vini, Joaquin!", thuhet në njoftimin e Interit.

#### Solskjaer: Merkato e mbyllur, çdo transferim tjetër do të jetë një bonus

Trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer, ka deklaruar për "Sky Sports" se me shumë gjasë merkatoja e "djajve" për këtë sezon vere është e mbyllur. "Nuk mendoj se do të ndodhin më shumë gjëra. Nëse do të vijë ndonjë përforcim, atëherë ai do të jetë një bonus më shumë për ne. Ju e dini që në futboll asnjëherë nuk i dihet se çfarë mund të ndodhë", ka thënë Solskjaer. Duke folur për transferimet e kryera deri më tani, trajneri norvegjez ka deklaruar: "Jam shumë i kënaqur me atë që ndodhi gjatë merkatos. Jam i kënaqur me klubin". Manchester United solli në "Old Trafford", Jadon Sancho, Raphael Varanen dhe Tom Heatonin.

#### Kjo është arsyeja pse Chelsea transferoi Lukakun para Haalandit

Kampionia evropiane, Chelsea, ishte e interesuar për transferimin e sulmuesit të Borussia Dortmundit, Erling Haaland, por me kalimin e kohës klubi anglez "harrojë" Haalandin dhe e transferoi Romelu Lukaku nga Interi. Tani është bërë me dije se pse Chelsea refuzoi ta transferonte Haalandin për shkak të kërkesës së agjentit të yllit norvegjez, Mino Raiola. Ky i fundit kishte kërkuar nga Chelsea një pagë prej 50 milionë eurosh në vit, raporton "Bild". Përveç pagës, Raiola kishte kërkuar edhe shumën që i paguhet agjentit si dëmshpërblim prej 40 milionë eurosh.

## Ankohet sportistja kineze: Është shlyer medalja e arit

Lojërat Olimpikë përfunduan me një qetësi të madhe nisur edhe nga fakti se ishin të mbizotëruara nga rregullat kundër Covidit dhe nuk u lejua prania e publikut të huaj, vetëm atij vendas. Por, si duket, jo çdo gjë ka shkuar vaj për shtetin organizator,

Japoninë. Fituesja e medaljes së arit në disiplinën e trampolinës në pishinë, Zhu Xejung, është bërë virale pasi ka bërë një ankesë aspak normale drejtuar Olimpiadës. Xejung pretendon se medalja e saj e arit ka filluar të shlyhet duke treguar cilësinë e

dobët të medaljeve. 23-vjeçarja postoi një fotografi të medaljes në platformën "Global Times" duke shkruar: "A ka mundësi që medalja të shlyhet kështu? Më lejoni ta sqaroj këtë gjë... Zbulova një shenjë në medaljen time, mendova se ishte papastërti

dhe e fërkova me gisht, por vërejtja se ishte nga cilësia e dobët dhe shenja u bë më e madhe", ka shkruar kinezja. Postimi u bë viral duke marrë mbi 20 mijë komente nga fansat të cilët akuzuan Japoninë për organizim të dobët të kompeticionit.



**Ndërmarrja Publike Lokale  
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**



Në bazë të rregullores për organizmin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, me nr. 01-011/02-187748/19, e dt. 01.08.2019, rregullores së brendshme për parkingjet me laura dhe rregullores së brendshme për dhënie në shfrytëzim të hapësirave të përkohshme në parkingjet me laura (Qershor, 2020), NPL "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë bën:

**NJOFTIM PUBLIK**

**Për dhënie në shfrytëzim të hapësirave publike në parkingjet me laura që menaxhohen nga NPL "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë.**

Kërkojmë partner biznesi për shfrytëzimin e shërbimeve të ofruara nga ndërmarrja nëpër hapësirat publike për parkim, përkatësisht në parkingjet me laura. Shërbimet duhet të jenë të kualitetit të lartë, sipas standardeve evropiane dhe standardeve në përputhje me të gjitha rregulloret e NPL "Prishtina Parking" Sh. A. Çmimet duhet të jenë të pranueshme, stabile dhe në harmoni me tregun vendor. Ftohen të gjithë të interesuarit që të konkurrojnë për shfrytëzimin e hapësirave në fjalë.

Kriteret minimale që kërkohen nga ndërmarrja janë si në vijim:

1. **Certifikatën e biznesit (bashkë me shtojcën mbi informatat e biznesit);**
2. **Certifikatën e TVSH dhe Numrin fiskal;**
3. **Selia dhe veprimtaria e biznesit duhet të jetë në Republikën e Kosovës;**
4. **Duhet të paraqitet ideja e planit fizik për shfrytëzimin e hapësirës publike;**

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Selia e Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë, Rr. "Luan Haradinaj", Pallati i Rinisë dhe Sporteve (ish ASK), p. n., Prishtinë, 10000, Kosovë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit nuk do të shqyrtohen. Afati për dorëzim të dokumentacionit do të jetë nga 27.08.2021 deri më 06.09.2021, ora 16:00.

Prishtinë, më 27.08.2021

NPL "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Adresa: Rr. Andrea Gropa, Nr. 40, Prishtinë 10000, Kosovë  
Telefoni: +383 (0) 38 224 228  
Email: info@prishtinaparking.net

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se N.SH. "AS ART&EVENT", Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik: 811543471 dhe me numër të biznesit: 80666802 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa N.SH. "AS ART&EVENT", Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik: 811543471 nr. biznes: 80666802 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the N.SH. "AS ART&EVENT", Vushtrri has come to the decision to quit its nr. Unik: 811543471 nr. business: 80666802 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**NJOFTIM**

**K.R.M." ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË,**  
ANULON pjesërisht Konkursin e publikuar me datë 05.08.2021, për këtë pozita:

- 2 /dy/ Punëtor Fizik Sezonal.

Ky anulim bëhet për shkaqe teknike, dhe i njëjti do të rishpallet me shtim të numrit nga 2 në 6.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Mergim Asani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. së dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë si dhe diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,  
Entrepreneurship and Trade

#### Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës

Bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars 2019), nenin 15 të Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, Rregulloren Nr.04/2017 për Këshillin e Akreditimit dhe Procedurën për Menaxhimin e Kompetencës (DAK-PT-02), Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës (DAK), shpall këtë:

#### FTESË PUBLIKE për ekspert teknik – anëtar të Këshillit të Akreditimit

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës (DAK) është i vetmi Trup Kombëtar i Akreditimit, i njohur me ligj, për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit që kryejnë aktivitetet të tilla si: testim, kalibrim, certifikim, dhe inspektim qofshin në sektorët publik apo privat, të fushës vullnetare apo të detyrueshme.

Me qëllim të realizimit të aktiviteteve të akreditimit, DAK përmes kësaj shpallje u bën ftesë të gjithë të interesuarve për të qenë pjesë e Këshillit të Akreditimit, të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formë-aplikimin (PT-02-F01);
- CV-në;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dokumentet që vërtetojnë përgatitjen profesionale dhe përvojën;
- Letrën e shprehjes së interesimit për të aplikuar /letër motivuese.

Të drejtë aplikimi për ekspert teknik – anëtar të Këshillit të Akreditimit kanë të gjithë kandidatet që plotësojnë kriteret, si në vijim:

- Diplomë universitare në fushën përkatëse;
- Përvojë relevante prej së paku pesë vite në fushën teknike përkatëse;
- Njohuri të standardit të akreditimit në fushën teknike përkatëse.

Me qëllim të sigurimit të barazisë gjinore dhe gjithë përfshirjes në ekspertizë dhe punë me përgjegjësi, inkurajohen të aplikojnë kandidatet e gjinisë femërore duke ju dhënë përparësi në kushtet e barabarta të kualifikimit.

#### Informata plotësuese:

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës e ka të ngritur skemën e akreditimit për laboratorë testues/kalibrues, trupa inspektues dhe laboratorë mjekësorë.

Për kryerjen e aktiviteteve të akreditimit, DAK-së i nevojiten ekspertët të këtyre fushave:

- Makineri;
- Ndërtimtari;
- Elektroteknikë;
- Kimi;
- Bujqësi;
- Mikrobiologji;
- Biologji;
- Farmaci.

#### Detyrat dhe Përgjegjësit të Këshillit të Akreditimit:

- Të ekzaminonjë të gjeturat dhe shënimet në dosjen e akreditimit përkatës;
- Të mbajë evidence për konkluzionet lidhur me dosjen e akreditimit;
- T'i jap rekomandimin Drejtorit të Përgjithshëm të DAK-së mbidhënien/refuzimin e akreditimit, zgjerimin e fushës, ri-akreditimin ose tërheqjen e akreditimit.

#### Kohëzgjatja e mandatit të Këshillit të Akreditimit dhe pagesa

Mandati i anëtareve të Këshillit të Akreditimit është tre (3) vjeçar me mundësi të ri-zgjedhjes edhe për një mandat të dytë.

Pagesa për anëtarët e Këshillit të Akreditimit bëhet për pjesëmarrje në takimet e Këshillit të Akreditimit sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 12/42 (datë 31.10.2008).

#### Periodha e aplikimit dhe dorëzimi i dokumentacionit:

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen e Ministrisë [mint.rks-gov.net](http://mint.rks-gov.net) dhe ueb faqen e DAK [dak.rks-gov.net](http://dak.rks-gov.net). Thirrja publike është e hapur deri me datë **02.09.2021**. Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës, në adresën: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" p.n. Lagja Spitalit 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, çdo ditë pune nga ora 8:00 - 16:00 ose në email adresën [valmira.b.sejdiu@rks-gov.net](mailto:valmira.b.sejdiu@rks-gov.net).

Aplikacionin (Formë-aplikimi PT-02-F01) mund ta merrni në ueb faqen zyrtare të DAK-së [dak.rks-gov.net](http://dak.rks-gov.net), në zyrën e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës ose mund ta kërkonit përmes email-it në: [valmira.b.sejdiu@rks-gov.net](mailto:valmira.b.sejdiu@rks-gov.net). Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-572.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,  
Entrepreneurship and Trade

#### Generalna Direkcija za Akreditaciju na Kosovu

Na osnovu člana 23 Zakona br. 06/L-113 o Organizaciji i Funkcionisanju Državne Uprave i Nezavisnih Agencija (Službeni List, br. 7/01 Marta 2019), član 15 Zakona br. 05/L-117 o Akreditaciji, Uredbi br. 04/2017 o Savetu za Akreditaciju i Postupak za Upravljanje Kompetencije (DAK-PT-02), Generalna Direkcija za Akreditaciju na Kosovu (DAK), objavljuje:

#### JAVNI POZIV za tehničkog stručnjaka - član Saveta za Akreditaciju

Generalna Direkcija za Akreditaciju na Kosovu (DAK) je jedino Nacionalno Akreditaciono Telo, priznato zakonom, koje u skladu sa međunarodnim standardima procenjuje tehničku kompetenciju TELA za Ocenjivanje Usaglašenosti koja obavljaju aktivnosti kao što su: testiranje, kalibracija, sertifikacija i inspekcija u javnom ili privatnom sektoru, dobrovoljnog ili obaveznog polja.

U cilju sprovođenja aktivnosti akreditacije, DAK ovim oglasom poziva sve zainteresovane strane da budu deo Saveta za Akreditaciju, da popune i dostave sledeće dokumente:

- **Obrazac za apliciranje (PT-02-F01);**
- **CV;**
- **Kopija lične karte;**
- **Dokument koji dokazuje profesionalnu pripremu i iskustvo;**
- **Pismo izražavanja interesa za apliciranje/motivaciono pismo.**

Za tehničkog stručnjaka - član Saveta za Akreditaciju - mogu aplicirati svi kandidati koji ispunjavaju sledeće kriterijume:

- Univerzitetska Diploma iz odgovarajuće oblasti;
- Relevantno iskustvo od najmanje pet godina u relevantnoj tehničkoj oblasti;
- Poznavanje standarda akreditacije u relevantnoj tehničkoj oblasti.

Kako bi se osigurala rodna ravnopravnost i uključivanje u stručnost i odgovoran rad, podstiču se da apliciraju kandidatkinje ženskog roda dajući im prednost pod jednakim uslovima kvalifikacije.

#### Dodatne Informacije:

Generalna Direkcija za Akreditaciju na Kosovu postavila je šemu akreditacije za laboratorije za testiranje/kalibraciju, inspeksijska tela i medicinske laboratorije.

Za obavljanje aktivnosti akreditacije, DAK -u su potrebni stručnjaci u ovim oblastima:

- Mašinerija;
- Građevinarstvo;
- Elektrotehnika;
- Hemija;
- Poljoprivreda;
- Mikrobiologija;
- Biologija;
- Farmacija.

#### Dužnosti i Odgovornosti Saveta za Akreditaciju:

- Ekzaminirati nalaze i beleške u relevantnom dosijeu o akreditaciji;
- Voditi evidenciju zaključaka u vezi sa dosijeom o akreditaciji;
- Dati preporuku Generalnom Direktor DAK-a o dodeljivanju/odbijanju akreditacije, proširenju obima, ponovnoj akreditaciji ili oduzimanju akreditacije.

#### Trajanje mandata Saveta za Akreditaciju i isplata

Mandat članova Saveta za Akreditaciju je tri (3) godine sa mogućnošću ponovnog izbora za drugi mandat.

Plaćanje članova Saveta za Akreditaciju obavlja se po učešću na sastancima Saveta za Akreditaciju u skladu sa Odlukom Vlade br. 12/42 (od 31.10.2008.).

#### Period apliciranja i podnošenje dokumentacije:

Oglas za javni poziv objavljuje se na veb stranici Ministarstva [mint.rks-gov.net](http://mint.rks-gov.net) i veb stranici DAK [dak.rks-gov.net](http://dak.rks-gov.net). Javni poziv je otvoren do **02.09.2021**.

Sva zainteresovana lica koja žele aplicirati prema javnom pozivu treba da izraze svoj interes dostavljanjem sve potrebne dokumentacije Generalnoj Direkciji za Akreditaciju na Kosovu, na adresu: Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine, Ulica "Arbënor e Astrit Dehari" b.br Bolničko Naselje 10000 Priština, Republika Kosovo, svakog radnog dana od 8:00 - 16:00 ili na e-mail adresu: [valmira.b.sejdiu@rks-gov.net](mailto:valmira.b.sejdiu@rks-gov.net).

Prijava (Obrazac za apliciranje PT-02-F01) može se dobiti na zvaničnoj veb stranici DAK-[adak.rks-gov.net](http://adak.rks-gov.net), u kancelariji Generalne Direkcije za Akreditaciju na Kosovu ili je možete zatražiti putem e-mail-a na: [valmira.b.sejdiu@rks-gov.net](mailto:valmira.b.sejdiu@rks-gov.net).

Za detaljnije informacije možete se obratiti na br. tel. 038-200 36-572.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

**MEKA**  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues